

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6541
E martë, 22 shkurt 2022
çmimi 0.40 €

Bien rastet me
Covid-19 | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PËRFUNDON PUNIMET KONFERENCA E SIGURISË NË MUNIH TË GJERMANISË

OSMANI DHE KURTI KTHEHEN PA SHTRËNGIM DUARSH ME ZËVENDËSPRESIDENTEN HARRIS DHE SEKRETARIN BLINKEN | FAQE 3



Presidentja Vjosa Osmani, kryeministri Albin Kurti dhe kryediplomatja Donika Gërvalla për tri ditë kanë qëndruar në Munihi të Gjermanisë në Konferencën për Siguri. Ata nuk kanë arritur të sigurojnë asnjë shtrëngim duarsh apo fotografi me zëvendëspresidenten amerikane Kamala Harris apo sekretarin Antony Blinken, të cilët ishin pjesë e kësaj konference. Pas përfundimit të kësaj konference, për takimet që kanë zhvilluar atje, Osmani dhe Kurti kanë shkruar në rrjete sociale, duke theksuar se kishin tri ditë intensive të diskutimit në një numër panelesh e tryezash dhe takimesh me përfaqësues të shteteve të tjera dhe të organizatave ndërkombëtare

OPINION

QËNDRIMI I FAKTORIT
NDËRKOMBËTAR GJATË
VITEVE 1995-1997 | F. 6

Prof. dr.
Sabit SYLA



AKTUALE



TË ENJTEN DEPUTETËT E KUVENDIT
MBAJNË SEANCË PLENARE | F. 7

SLLOVENIA HEQ SHUMICËN
E MASAVE PËR LUFTIM
TË PANDEMISË | F. 2

EKONOMI



DYFISHOHEN EKSPORTET E
SHQIPËRISË DREJT KOSOVËS | F. 8

KONJUFCA I OFRON MBËSHTETJE
BORDIT TË KPMM-së | F. 8

SPORT

AHMETI DHE EJUPI KONFIRMOJNË
KANDIDATURAT PËR KRYETAR
TË FFK-së | F. 10

Haradinaj: Të lejohen qytetarët të tërheqin para nga Trusti | FAQE 3



INTERVISTË ME
ISH-AMBAADORIN
E KOSOVËS NË
SHKUP, GJERGJ
DEDAJ

POLITIKA E JASHTME KA NGEÇJE

- Të ndalet linçimi brutal dhe diskreditimi
im institucional dhe antikushtetues

| FAQE 4-5

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Presidenti Putin mendon të njohë rajonet separatiste të Ukrainës lindore

Presidenti rus Vladimir Putin mblodhi të hënën zyrtarët e lartë për të shqyrtuar njohjen e pavarësisë së rajoneve separatiste në Ukrainën lindore, një veprim që do të rriste tensionet me Perëndimin mes frikës se Kremli mund të nisë një pushtim të afërt të Ukrainës.

Takimi i transmetuar publikisht, i

regjistruar paraprakisht i Këshillit të Sigurimit presidencial erdhi në mes të një shpërthimi të përleshjeve në Ukrainën lindore që fuqitë perëndimore besojnë se Rusia mund ta përdorë si një pretekst për një sulm ndaj demokracisë me pamje perëndimore që ka sfiduar përpjekjet e Moskës për ta tërhequr

atë, në orbitën e saj.

Me rreth 150,000 trupa ruse të grumbulluara në tre anët e Ukrainës, SHBA-ja ka paralajmëruar se Moska tashmë ka vendosur të pushtojë. Megjithatë, presidentët amerikanë dhe rus ranë dakord paraprakisht për një takim të mundshëm në një përpjekje të fundit për të shmangur

luftën.

Nëse Rusia pushton, takimi do të ndërpritet, por perspektiva e një samiti ballë për ballë ringjalli shpresat se diplomacia mund të parandalonte një konflikt shkatërrues, i cili do të rezultonte në viktima masive dhe dëme të mëdha ekonomike në të gjithë Evropën, e cila varet shumë nga Rusia.



Borrell sheh rrezik për shpërbërjen e Bosnjës

BRUKSEL, 21 SHKURT - Përfaqësuesi i lartë i bllokut evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell, ka tërhequr vërejtjen për mundësinë e shpërbërjes së Bosnjës e Hercegovinës. Ai kërkoi nga ministrat e shteteve anëtare të BE-së që të marrin vendime për ta ndaluar krizën e thellë politike në këtë shtet të Ballkanit Perëndimor.

Këto komente Borrelli i bëri para takimit të ministrave të Jashtëm të BE-së të cilët do të diskutojnë për krizën në Ukrainë dhe për situatën e sigurisë në Bosnjë. “Mos e mohoni rëndësinë e asaj që po ndodh në Bosnjë e Hercegovinë. Kjo do të marrë një pjesë të rëndësishme të kohës në takimin tonë sepse retorika nacionaliste dhe separatiste po rritet në Bosnjë e Hercegovinë



dhe rrezikon stabilitetin, madje edhe integritetin vendit”, ka thënë Borrell, duke shtuar se ministrat e BE-së do të duhet të marrin vendim se si të ndalin këtë dinamikë në Bosnjë e Hercegovinë dhe të evitojnë që

shteti të shpërbëhet në disa copa. “Kjo është një situatë kritike dhe ministrat duhet të miratojnë disa vendime për këtë gjë”, ka pohuar Borrell.

Në një dokument të përgatitur nga shërbimet e BE-së për

takimin e sotëm, është thënë se “kriza politike në Bosnjë e Hercegovinë është më e thella që nga përfundimi i luftës më 1995”. BE-ja pritet sot të diskutojë edhe për mundësinë e vendosjes së sanksioneve ndaj liderëve politikë në Bosnjë e Hercegovinë, të cilët shihen si përgjegjës për rrezikimin e unitetit, sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit.

Shtetet e Bashkuara veçse kanë vendosur sanksione ndaj liderit të serbëve të Bosnjës, Millorad Dodik, për përfshirje në korrupsion. Uashingtoni ka thënë se me veprimet e tij për të transferuar disa kompetenca shtetërore në nivelin e entitetit të Republikës Sërpska, Dodik ka minuar stabilitetin e rajonit.

Në dokumentin e përgatitur, po ashtu, kërkohet që të ndalen

proceset secesioniste në entitetin e serbëve të Bosnjës si dhe të arrihet pajtim për reformën zgjedhore, në mënyrë që zgjedhjet e planifikuara për në vjeshtë, të zhvillohen sipas standardeve evropiane. Borrell më 20 shkurt kishte ndezur alarmin, pasi nacionalistët kroatë të Bosnjës paralajmëruan se do t'i prishnin zgjedhjet e ardhshme dhe do ta formonin rajonin e tyre. Në takimin që mbahet në Bruksel, ministrat e BE-së do të diskutojnë edhe për krizën në Ukrainë.

Shtetet e Bashkuara dhe shtetet e tjera perëndimore kanë thënë se Rusia ka vendosur që ta pushtojë Ukrainën teksa ka grumbulluar mbi 150 000 trupa përgjatë kufijve ukrainas. Por, Moska vazhdimisht mohon se ka plane për pushtim.

Kina sanksionon dy kompani amerikane të armëve

PEKIN, 21 SHKURT - Kina ka vendosur sanksione ndaj dy kompanive amerikane të armëve, Lockheed Martin Corp dhe Raytheon Technologies Corp, për shkak të shitjes së armëve në Tajvan.

Sanksionet janë kundërmasa ndaj dy kompanive të cilat më 7 shkurt shitën armë në vlerë mbi 100 miliardë dollarë. Kina ka njoftuar se kjo shitje “mino interesat e sigurisë kineze, minoi seriozisht raportet Kinë - ShBA dhe paqen dhe stabilitetin në Ngushticën e Tajvanit”, ka deklaruar zëdhënësi i Ministrisë së

Jashtme kineze, Wang Wenbin. Pekini ka njoftuar se ishulli i Tajvanit është provincë e shkëputur dhe se duhet të bashkohet me Kinën. “Në përputhje me masat përkatëse të ligjit për sanksionet kundër të huajve, qeveria kineze ka vendosur që të ndërmarrë kundërmasa për shkak të shkeljeve nga Raytheon Technologies dhe Lockheed Martin”, ka thënë Wang. “Që të dy këto kompani janë kompani ushtarake dhe për një kohë të gjatë kanë marrë pjesë në shitjen e armëve amerikane në rajonin kinez të Tajvanit”.

Megjithatë, autoritetet kineze nuk kanë dhënë detaje lidhur me natyrën e sanksioneve që kanë vendosur ndaj këtyre kompanive amerikane.

Kjo është hera e parë që kompanitë përballen me sanksione në bazë të ligjit të ri të Kinës për sanksionet ndaj të huajve, që u miratua vitin e kaluar në përgjigje të sanksioneve amerikane kundër kompanive kineze.

Kina edhe më 2019 dhe 2020 kishte njoftuar për sanksione ndaj kompanive Lockheed dhe Raytheon, por Pekini nuk kishte dhënë detaje.



Sllovenia heq shumicën e masave për luftim të pandemisë



LUBJANË, 21 SHKURT - Ljubjanë, 21 shkurt - Sllovenia ka hequr të hënën, më 21 shkurt, shumicën e masave për luftim të pandemisë së koronavirusit. Vizitorët nëpër restorante, hotele dhe ambiente të tjera nuk kanë më

nevojë të dëshmojnë se kanë qenë të vaksinuar, janë shëruar nga koronavirusi apo kanë test negativ, ka raportuar agjencia e lajmeve, STA, duke cituar vendimet e qeverisë gjatë fundjavës. Udhëtarët që shkojnë atje nuk

kanë nevojë ta prezantojnë statusin e tyre për koronavirus. Edhe ora policore nuk do të zbatohet më.

Restorantet do të mund të jenë të hapura deri në orët e vona. Sa i përket vendosjes së maskës, ajo është ende e

obligueshme në ambiente të mbyllura. Numri i rasteve të infektimit në këtë shtet me 2 milionë banorë ka rënë në kohën e fundit. Mesatarja e shtatë ditëve të fundit flet për 4 248 raste të infektimit për 100 000 banorë.

PËRFUNDON PUNIMET KONFERENCA E SIGURISË NË MUNIH TË GJERMANISË

Osmani dhe Kurti kthehen pa shtrëngim duarsh me zëvendëspresidenten Harris dhe sekretarin Blinken

Presidentja Vjosa Osmani, kryeministri Albin Kurti dhe kryediplomatja Donika Gërvalla për tri ditë qëndruan në Munih të Gjermanisë në Konferencën për Siguri. Ata nuk arritën të sigurojnë asnjë shtrëngim duarsh apo fotografi me zëvendëspresidenten amerikane Kamala Harris apo sekretarin Antony Blinken, të cilët ishin pjesë e kësaj konference. Pas përfundimit të kësaj konference, për takimet që kanë zhvilluar atje, Osmani dhe Kurti kanë shkruar në rrjetet sociale, duke theksuar se ishin tri ditë intensive të diskutimit në një numër panelesh e tryezash dhe takimesh me përfaqësues të shteteve të tjera dhe të organizatave ndërkombëtare

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 SHKURT - Ka përfunduar konferenca dyditore e Sigurisë në Munih të Gjermanisë. Pjesëmarrës ishin liderët e të gjitha vendeve të botës demokratike, përfshirë këtu edhe presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti. Takime të ndryshme kanë zhvilluar edhe Osmani dhe Kurti me përfaqësues të vendeve të ndryshme, por jo me udhëheqësit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Osmani, Kurti dhe Gërvalla nuk arritën të sigurojnë asnjë shtrëngim duarsh apo fotografi me zëvendëspresidenten amerikane Kamala Harris apo sekretarin Antony Blinken të cilët ishin pjesëmarrës në këtë konferencë. Por, në të kaluarën, kur Kosova përfaqësohej nga ish-presidenti Hashim Thaçi, ai arrinte të takohej në këtë forum me liderët më të rëndësishëm të botës që ishin të pranishëm aty. Në konferencën e vitit 2019 ish-presidenti Hashim Thaçi ishte takuar me presidentin aktual të ShBA-së, Joe Biden. Thaçi atëkohë ishte takuar edhe me Nancy Pelosi, kryetaren e Dhomës së Përfaqësuesve dhe kryetarin e Komitetit për Politikë të Jashtme të ShBA-së.

Në takimin e vitit 2020 ish-presidenti Thaçi ishte takuar me senatorë të rëndësishëm amerikanë, por edhe me të dërguarin e posaçëm të ish-presidentit Donald Trump, ish-ambasadorin Richard Grenell, si dhe këshilltarin e presidentit Trump për sigurinë.

Pas përfundimit të kësaj konference, për takimet që kanë

zhvilluar atje, Osmani dhe Kurti kanë shkruar në rrjetet sociale. Presidentja Osmani ka thënë se ishin tri ditë intensive në Konferencën e Sigurisë në Munih, ku së bashku me kryeministrin Kurti dhe zëvendëskryeministrin Gërvalla kanë diskutuar në një numër panelesh e tryezash dhe kanë takuar përfaqësues të shteteve të tjera dhe të organizatave ndërkombëtare. "Në të gjitha këto organizime si dhe takime e diskutime bilaterale përçuan mesazhin se Kosova është shembull i shkëlqyeshëm i kontributit për paqe e stabilitet në rajon, duke kryer njëkohësisht një sërë reformash brenda vendit të cilat po përkrahen fuqishëm nga qytetarët dhe nga partnerët ndërkombëtarë.

Përkushtimin tonë në procesin e integritimit në struktura euroatlantike, përtej aspektit deklarativ, po e dëshmojmë me veprime konkrete, prandaj është imperative që e ardhmja e vendit tonë në këto struktura të garantohet duke pasur parasysh ndikimin çdo ditë e më të madh të Rusisë nëpërmjet Serbisë që ka për qëllim destabilizimin e rajonit", ka thënë Osmani. Ajo ka shtuar se në këto takime me presidentë, kryeministra, ministra të jashtëm, ministra të mbrojtjes, senatorë, udhëheqës të organizatave ndërkombëtare e përfaqësues të shoqërisë civile, gjithnjë synojnë avancimin e raporteve me shtete të tjera dhe shtyrjen përpara të interesave të Republikës së Kosovës dhe të qytetarëve të saj. "Kosova ka miq të shumtë në botë, e këto miqësi vetëm sa do t'i shtojmë e do t'i thellojmë", ka deklaruar presidentja Osmani.

Edhe kryeministri Kurti ka thënë se për dy ditë e gjysmë të Konferencës së Sigurisë në Munih, bashkë me zëvendëskryeministrin Gërvalla, zhvilluan 17 takime bilaterale e biseda me liderë e përfaqësues politikë nga Evropa dhe bota. "Për marrëdhëniet bilaterale dhe fushat e bashkëpunimit biseduam me kryeministrin e Estonisë, Kaja Kallas, me kryeministrin e Bullgarisë, Kiri Petkov, dhe me kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Dimistar Kovaçevsik. Kurse bashkë me presidenten Vjosa Osmani Sadriu takuam kryeministrin grek Kyriakos Mitsotakis, ku theksuam rëndësinë e njohjes së shtetit të Kosovës nga Greqia, si hap i radhës i natyrshëm drejt thellimit të mëtutjeshëm të raporteve mes dy shteteve tona", ka njoftuar Kurti.

Ai ka treguar se në takime të ndara me përfaqësuesin e lartë të Bashkimit Evropian, Josep Borrell, dhe me përfaqësuesin Special të Bashkimit Evropian, Miroslav Lajčak, diskutuam për procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Ndërkaq në takimin me komisionarin e Bashkimit Evropian për Buxhet dhe Administratë, Johannes Hahn, kërkua dhe morëm premtim për më shumë

mbështetje financiare dhe teknike në fushën e arsimit dhe punësimit të rinjve. Po ashtu, takuam ministrin e Punëve të Jashtme të Australisë, Marise Payne, ministrin e Punëve të Jashtme të Suedisë, Ann Linde, zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme të Jordanisë, një prej shteteve të para të Lindjes së Mesme që kanë njohur republikën tonë, Ayan Safadi dhe ministrin gjerman të Ushqimit dhe Bujqësisë, Cem Ozdemir. Të gjithë i falënderuam për marrëdhëniet e mira dhe i shkëmbyem zotimet tona për përparimin e tyre", ka thënë Kurti. Ai ka bërë me dije se në ditën e dytë të kësaj konference takuan senatorin amerikane të shtetit të Iowas, miken e Kosovës, Joni Ernst, së cilës i shprehën mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Me zëvendëskryeministrin Gërvalla zhvilluam takime dhe me udhëheqësit e subjekteve politike gjermane, kryesuesin e SPD-së gjermane, Lars Klingbeil, me kryetarin e Unionit Kristian Demokratik të Gjermanisë, Friedrich Merz, dhe bashkëdrejtuesin e Partisë së Gjellbër gjermane, deputetin Omid Nouripour. Gjithashtu, takuam

edhe lideren opozitare të Bjellorusisë, Sviatlana Tsikhanouskaya dhe përfaqësuesin e lartë për Bosnjë e Hercegovinë, Christian Schmidt", është shprehur Kurti.

Ai ka theksuar se mundësitë dhe potencialin për investime në Kosovë i ka paraqitur gjatë një dreke pune me ndërmarrës dhe investitorë të huaj në kuadër të Forumit Angermyer të Politikës dhe Inovacionit. "Si pjesë e panelit të titulluar 'Humbur në tranzicion: Sfidat dhe perspektivat e llogaridhënies dhe drejtësisë tranzicionale' ritheksova domosdoshmërinë e hapjes së arkivave shtetërore në Serbi, pasi krimet e kryera në Kosovë ishin krime të kryera nga shteti i Serbisë. Kurse në panelin 'Rezistenca e fushëbetejës? Forcat rezervë si mbështetje e nevojshme për Forcat e Armatosura' fola për buxhetin tonë të rritur për Forcat e Sigurisë së Kosovës dhe për përkushtimin e qeverisë për modernizimin e Ushtrisë. Çështja e personave të zhdukur me dhunë gjatë luftës së fundit në Kosovë ishte tema e takimit me presidentin e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (ICRC), Peter Maurer", ka deklaruar Kurti.

Haradinaj: Të lejohen qytetarët të tërheqin para nga Trusti



PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se duhen lejuar qytetarë të tërheqin para nga Trusti. Ai ka thënë se qytetarët në Kosovë janë në një situatë tejet të vështirë ekonomike e sociale. "Shtrenjtimi i

artikujve elementarë për jetesë ka shtyrë shumë kategori që të përballen gjithnjë e më shpesh me mbijetesën ekonomike. Prandaj e konsideroj si hap të parë urgjent aprovimin e një vendimi që lejon qytetarët të tërheqin një përqindje të caktuar të mjeteve nga trusti

pensional. Situata është e jashtëzakonshme, prandaj edhe vendimet duhet të jenë të jashtëzakonshme. Krahas kësaj mase, qeveria duhet të mendojë edhe për masa të tjera, në këtë kohë vështirë të përballueshme për qytetarët", ka thënë Haradinaj.



INTERVISTË ME ISH-AMBASADORIN E KOSOVËS NË SHKUP, GJERGJ DEDAJ

Politika e jashtme ka ngecje

- Të ndalet linçimi brutal dhe diskreditimi im institucional dhe antikushtetues

Ish-ambasadori i Kosovës në Shkup, Gjergj Dedaj, ka theksuar edhe një herë se shkarkimi i tij nga misioni diplomatik në Maqedoninë e Veriut ishte skandaloz, antikushtetues dhe në kundërshtim me Konventën e Vjenës. Dedaj në këtë intervistë dhënë për “Epokën e re”, për shkarkimin e tij e ka fajësuar presidenten e vendit, Vjosa Osmani që, sipas tij, në këtë pozitë e vendosi bashkëshortin e saj, Prindon Sadriu. Dedaj ka thënë se me këtë qeverisje vendi nuk ka përparim. Sipas tij, në politikën e jashtme ka ngecje. Përveç pandemisë, ish-ambasadori Dedaj ka theksuar se Kosovën e kanë goditur rëndë problemet sociale dhe ekonomike

EPOKA E RE**Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 21 SHKURT -

“Epoka e re”: Z. ambasador Dedaj, u bënë më shumë se tetë muaj nga shkarkimi juaj nga pozita e ambasadorit në Shkup. Na tregoni se çfarë jeni duke bërë tani?

Dedaj: Ç’është e vërteta largimi im nga kreu i ambasadës së Kosovës në Shkup nga presidentja Osmani ishte skandaloz, në kundërshtim me ligjin, antikushtetues dhe në

kundërshtim me Konventën e Vjenës. Pra largimi im ishte brutal, linçim, tentim për diskreditim dhe puro hakmarrje mesjetare politike. Të dymbëdhjetë ambasadorët brilantë të Kosovës u shkarkuan politikisht në qendrat kryesore të vendosjes, gjë të cilin unë e vlerësova si një tentim për grushtshtet me metoda diktatoriale, mu për këtë njëmbëdhjetë ambasadorëve të tjerë iu dha afati prej tre muajve për ta kryer përmes procedurave të rregullta misionin e tyre

diplomatik, kurse vetëm mua kundërligjshëm dhe në mënyrë ultimative, jonjerëzore, më është dhënë afat vetëm një ditë për ta liru misionin. Ky ishte atak në personalitetin tim dhe në përfaqësinë e shtetit të Kosovës. Ky veprim i kreut të shtetit, e cila me Kushtetutën e Kosovës obligohet dhe personifikon unitetin qytetar, në fakt ishte kundërkushtetues, përçarës dhe kundër unitetit qytetar. Ishte, thjesht, një hakmarrje politike e cila nuk ndodh në shtetet demokratike, por në vendet e

diktaturave dhe huntave ushtarake. Zonja e parë, veç të tjerash, këtë e bëri për ta sjellë në krye të ambasadës “zotërinë e parë”, respektivisht bashkëshortin, praktikë kjo staliniste dhe nepotiste. Një politikë e tillë përçarëse dhe keqpërdoruese ka sjellë edhe zhgënjimin qytetar. Jo rastësisht në sondazhin e fundit ajo ka vetëm 7 për qind të besueshmërisë qytetare dhe, nëse vazhdon kështu, nuk ka legjitimitet qytetar për të qenë në krye të Republikës së Kosovës, e për këtë duhet të mendojnë institucionet e shtetit tonë. Megjithatë unë këtë kohë sa jam pa punë angazhimin tim po ia kushtoj familjes sime, nipave, mbesave dhe miqve të mi, të cilët më kanë munguar shumë, si dhe po shkruaj për tri dekadat e angazhimit tim të përgjakshëm politik, që nga vitet e '90, duke

qenë kontribuues i drejtpërdrejtë dhe pjesë e të gjitha zhvillimeve historike të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Në fakt, kam menduar sikur ta kisha kryer misionin tim të rregullt ligjor katërvjeçar në krye të ambasadës në Shkup, ndoshta edhe të tërhiqem nga politika, por tani kam vendosur t'i vazhdoj betejat e mia politike për të dhënë kontributin tim për demokratizimin e Kosovës, vlerat euroatlantike, perspektivën evropiane, respektimin e barazisë dhe drejtësisë qytetare, etnike, fetare, racore dhe gjinore, mbrojtjen e të drejtave njerëzore, sundimin e ligjit si dhe kundërshtimin e nepotizmit, fanatizmit partiak, diskreditimit, kapjes së shtetit, cenimit të partneritetit me ShBA-në, NATO-n dhe Bashkimin Evropian, si dhe dinamizimin e integritimit

euroatlantik të Kosovës.

“Epoka e re”: *A keni ende kontakte me liderët dhe korin diplomatik të Maqedonisë së Veriut?*

Dedaj: Për gjysmë mandati sa isha në krye të misionit në Shkup, në kohë shumë të rënda nga pandemia e virusit Covid-19 dhe angazhimet e mia diplomatike në shtetin mik dhe fqinj të Republikës së Maqedonisë së Veriut, jam pritur shkëlqyer nga institucionet dhe forcat politike, kori diplomatik, shoqëria civile, pushteti lokal, komunitetet fetare, mediet dhe bota e biznesit. Për çka jam shumë mirënjohës dhe falënderues për të gjithë. Rregullisht mbaj kontakte dhe kam takime me personalitete dhe miq të shumtë në Shkup, me të cilët bisedoj për zhvillimet në Kosovë, për perspektivën euroatlantike të dy vendeve tona fqinje dhe të tërë rajonit. Natyrisht se i kam njoftuar edhe për tendencat e linçimit dhe diskreditimit tim, siç i kam njoftuar edhe institucionet ndërkombëtare të Bashkimit Evropian, ato të Këshillit të Evropës, të të Drejtave të Njeriut, institucionet politike, partitë parlamentare, institucionet e drejtësisë, sigurisë, të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, si dhe korin diplomatik të akredituar në Kosovë.

“Epoka e re”: *Si e vlerësoni qeverisjen aktuale, respektimin e të drejtave të njeriut, barazinë dhe sundimin e ligjit në Kosovë?*

Dedaj: Si promotor kampion dhe veteran i vlerave të liberal demokracisë perëndimore dhe euroatlantike, si ish-nënkryetar i Internacionales Liberale me seli në Londër dhe ish-kandidat për nënkryetar të Aleancës Liberal Demokratike të Evropës (ALDE), me seli në Bruksel, asnjëherë nuk kam qenë ithtar i pushtetit monist dhe njëpartiak. Në vendet në tranzicion siç është Kosova kjo nuk funksionon, duhet një gjithëpërfshirje, ndarje e përgjegjësi, unitet dhe ekspertizë në qeverisje dhe përvojë në legjislacion, ku shumica deputetëve janë praktikantë. Andaj lypset përvojë për shtetndërtim, në negociata me Serbinë, në anëtarësimet ndërkombëtare, në politikën e jashtme dhe kjo, në fakt, po ngec, nuk ka progres dhe vërehet një degradim institucional. Këtë e dëshmojnë edhe rezultatet debakël të zgjedhjeve lokale të 14 nëntorit dhe sondazhet për rënien drastike të besueshmërisë dhe legjitimitetit qytetar për institucionet e Kosovës. Njëkohësisht vërehet një rrënim i diplomacisë dhe bashkëpunimit ndërkombëtar të Kosovës. MPJD ngjan në një OJQ apo zyrë partiake, ndërkaq ambasadat dhe përfaqësitë diplomatike të Kosovës janë mbushur me militantë partiakë dhe amatorë.

Po ashtu, vërehet një ftohje e raporteve me ShBA-në, BE-në dhe Shqipërinë, e cila gjë në asnjë rrethanë dhe për asnjë çmim nuk do të duhej të ndodhte. Partneriteti i thellë me këto vende është historik, strategjik dhe jetik për të ardhmen e Kosovës euroatlantike, demokratike si dhe për paqen, sigurinë dhe stabilitetin e Kosovës. Kushdo që cenon këtë partneritet rrënon lirinë dhe të ardhmen euroatlantike të shtetit të Kosovës. Zaten pavarësia e Kosovës është projekt i përbashkët me ShBA-në, BE-në dhe NATO-n. Pra janë bërë sakrificat shekullore dhe pavarësia i ka rrënjët e saj të angazhimeve politike që nga vitet '90, pastaj me luftën çlirimtare, të pastër dhe heroike të UÇK-së, konferencën e Rambujesë, ndërhyrjen e NATO-s, marrëveshjen e Kumanovës, planin e ish-presidentit Ahtisari, bisedimet në Vjenë dhe shpalljen e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008. Pretendimet dhe ambicet narcisoide, të sëmura dhe të kota të rishkrimit të historisë, janë vetëm humbje kohe. Historia tashmë ka ndodhur dhe ajo e Kosovës është shkruar dhe vulosur. Pushteti aktual dhe pushtetet e tjera në vijimësi e kanë për obligim t'i respektojnë sakrificat, dëshmorët, martirët dhe invalidët e UÇK-së, pastaj Kushtetutën, ligjet, progresin ekonomik, barazinë qytetare, demokracinë, integritetin dhe sovranitetin e vendit, partneritetin me miqtë, si dhe integrimin euroatlantik të Republikës së Kosovës. Sa iu përket të drejtave të njeriut, ato janë të rrezikuara si kudo në Ballkanin Perëndimor, kanë një shpërfillje dhe disonancë mes asaj çfarë thuhet në fushatat elektorale, propagandat partiake

dhe asaj së vërtetë me çka ballafaqohen qytetarët e Kosovës. Përveç pandemisë, Kosovën e kanë goditur rëndë problemet sociale dhe ekonomike, rritja e pakontrolluar e çmimeve të energjisë dhe koston ditore të jetesës, të cilat janë buzë shpërthimit dhe revoltës qytetare, pastaj sindromi i shpërnguljes së trurit dhe të rinjve, pozita e mjerueshme e pensionistëve, gjendja e rëndë në arsim e shëndetësi si dhe tendencat për kapjen e shtetit, të drejtësisë dhe kontrolli mbi ligjin, nepotizmi dhe synimet tendencioze për kontrollin dhe sulmin mbi lirinë e shtypit dhe mediet e lira, duke mos ngurruar që zyrtarët kosovarë t'i quajnë mediet “ndërmarrje të përbashkëta kriminale”, madje të kalojnë të pandëshkuar, me qëllim të cenimit dhe rrezikimit të vet gazetarëve dhe pavarësisë së medieve, e këto janë simptoma dhe sindroma të një shteti diktatorial.

“Epoka e re”: *Kohë më parë ju kishit një përplasje mediatike me presidenten Vjosa Osmani dhe bashkëshortin e saj, i cili është edhe ushtrues detyre i ambasadorit në Shkup. Madje u tha se goja jeni edhe në kërkim nga Policia e Kosovës. Çfarë mund të na thoni për të gjitha këto?*

Dedaj: Bashkëshortët Osmani, siç po i quani zonja dhe “zotëria i parë”, është mirë ta ndalin linçimin dhe diskreditimin tim, madje është obligim i tyre ligjor dhe kushtetues të mos e keqpërdorin pushtetin dhe pozitën për denigrimin tim dhe të rivalëve të tyre politikë. Pas shkarkimit brutal dhe skandaloz të cilin ma ka bërë presidentja Osmani, ajo ka sjellë në krye të Ambasadës në Shkup bashkëshortin e saj, dukuri kjo e shteteve dhe tiranive monarkiste

dhe diktoriale. Duke qenë të vetëdijshëm se ndaj meje kanë bërë sulm të paramenduar, me urrejtje dhe fanatizëm. Ata për të justifikuar këtë konflikt interesi, këto shkelje flagrante kundër meje, nuk po pushojnë me shantazhe nder më të ulëtat. Më 17 janar të këtij viti në shumë portale dhe medie u lansua lajmi i trishtë dhe i rremë, siç i thonë, “fake news”, se goja unë jam në kërkim të Policisë së Kosovës, me shumë gjasa lajmi i sajuar dhe i dirigjuar nga Ambasada e Kosovës në Shkup apo MPJD në Prishtinë. Përmes kësaj gënjeshtre institucionale, shpifjeve djallëzore, kishin për qëllim krijimin e hutisë në opinion për diskreditimin tim dhe justifikimin e të bëmave të tyre jonjerëzore dhe skandaloze me rastin e shkarkimit tim, për çka unë përmes avokatit kam ushtruar padi në gjykatë, nëse edhe ajo nuk është e kapur si shumë segmente të tjera në Kosovë. Pra bëhej fjalë për tabelat diplomatike të makinës sime private, të lëshuara nga RMV, të paguara nga vetë unë dhe me afat deri më 31 dhjetor 2021, si dhe për ID-në time personale diplomatike me afat deri më 31 dhjetor 2022, të lëshuar nga autoritetet e Shkupit zyrtar, të cilat, pas festave të fundvitit, i kam dorëzuar vullnetarisht tek autoritetet përkatëse. Policia e Kosovës më ka thënë se lajmi që ju jeni në kërkim është i rremë dhe se askush nuk po ju kërkon. I irrituar tej mase, i shantazhuar, në gjendje fyese emocionale, jam prononcuar dhe kam kundërshtuar ashpër këto tendenca djallëzore. Në njërën nga studiot televizive kam ftuar për kujdes dhe përgjegjësi ndaj meje, ndaj jetës sime, sepse ndihesha i rrezikuar, kërcënuar dhe i nxitur, gjë e cila rrezikonte

jetën time, kam përkujtuar çdo individ i cili mendon të kërcënojë dhe rrezikojë jetën time, apo jetën e kujdo qoftë, nuk duhet të harrojmë se veç ligjit, te shqiptarët, fatkeqësisht, është edhe kanuni dhe secili duhet të kemi kujdes se si i trajtojmë njerëzit dhe jetën e tyre. Aty kam shtuar se unë jam një ndër kampionët e demokracisë në Kosovë dhe se çfarëdo kontesti me bashkëshortët Osmani apo me këdo tjetër do ta zgjidh vetëm përmes drejtësisë dhe rrugëve ligjore.

Shumë e pakënaqur për moskërkimin tim nga policia, presidentja Osmani vetëm pse unë e kam përdorur shprehjen kanun, pa ia drejtuar asaj dhe askujt në botë, sepse nga zhargoni im dhe edukata ime, kërcënimi nuk ka ekzistuar dhe as nuk është praktikë e imja tash dhe as në të ardhmen, madje as kur jam rrezikuar dhe kërcënuar me qindra herë gjatë karrierës sime politike. Presidentja Osmani duke keqpërdorur pushtetin dhe pozitën, për t'i arritur qëllimet e veta të frikshme për diskreditimin dhe linçimin tim, ka ushtruar kallëzim penal ndaj meje, së paku me qëllim të më ftoj në polici. Policia e Kosovës, e obliguar dhe në mënyrë profesionale, me korrektësi dhe me përgjegjësi më ka ftuar të jap deklaratë. I kam kundërshtuar ashpër pretendimet shpifëse të presidentes. E kam kontaktuar avokatin nga i cili kam kërkuar të ushtrojë kallëzim penal kundër presidentes Osmani për shpifje, por avokati më ka thënë se ajo ka imunitet dhe nuk mund t'i bëni kallëzim penal. Pra ajo ka keqpërdorur edhe imunitetin, edhe pozitën, pushtetin dhe ndikimin e saj kundër meje. Kjo është shkelje kushtetuese dhe ligjore.



QËNDRIMI I FAKTORIT NDËRKOMBËTAR NDAJ KËRKESAVE TË SHQIPTARËVE
TË KOSOVËS PËR PAVARËSI 1990-1999 (3)

Qëndrimi i faktorit ndërkombëtar gjatë viteve 1995-1997



Prof. dr. Sabit SYLA

Gjatë viteve 1992-1995 komuniteti ndërkombëtar ishte i angazhuar kryesisht në ndaljen e konflikteve të armatosura në Kroaci dhe Bosnje-Hercegovinë. Derisa në aspektin e jashtëm Kosova u la në harresë, në aspektin e brendshëm në Kosovë vazhdonte dhuna sistematike policore serbe. Gjitha institucionet shoqërore-ekonomike e politike ishin uzurpuar nga Serbia, mbi 30.000 punëtorë shqiptarë ishin dëbuar nga vendet e tyre të punës, nxënësit, studentët e mësimdhënësit nga shkollat e fakultetet. Filloi të mbizotëronte një gjendje e rëndë ekonomike. Tashmë në këto momente të vështira ekzistonte solidariteti popullor dhe organizimi për ndërtimin e institucioneve paralele. Shqiptarët në Kosovë

kishin ngritur sistemin e pavarur arsimor - shtëpi/shkollat, institucionet shëndetësore - nëpër shtëpi private, me një rezistencë pasive kundër okupimit serb.

Në këtë periudhë daljen nga kjo gjendje e vështirë elita politike shqiptare e kohës e shihte tek përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar për t'i dhënë fund luftimeve në Bosnjë-Hercegovinë e me këtë edhe gjetjen e një zgjidhjeje politike për Kosovën. Pasi që Evropa nuk kishte qenë në gjendje ta zgjidhte krizën në Bosnjë-Hercegovinë, dhe për të parandaluar zgjerimin e krizës dhe përfshirjen e shteteve tjera në të, një përgjegjësi të tillë e mori përsipër administrata e presidentit Bill Clinton. SHBA organizoi Konferencën e Dejtonit, që u mbajt në nëntor 1995. Por, Kosova nuk ishte ftuar në këto bisedime pasi që gjasat për arritjen e paqes do të ishin më të vogla nëse do të diskutoheshin probleme të tjera dhe se pjesëmarrja e Kosovës mund të ishte shkas për zemërimin e Millosheviqit, i cili shihej nga ndërkombëtarët si çelës i arritjes së paqes. Refuzimi i faktorit ndërkombëtar

për ta trajtuar çështjen e Kosovës në Dejton shkaktoi një zhgënjim dhe pakënaqësi të përgjithshme në Kosovë. Përfundimi nuk e kishte shpërblyer durimin e popullit dhe punën e liderit të shqiptarëve të Kosovës, Ibrahim Rugovës, pavarësisht vlerësimeve pozitive për rezistencë paqësore. Bashkimi Evropian vazhdoi me qasjen se raportet e përmirësuar midis BE-së dhe RFJ-së mund të çonin deri tek një qasje "konstruktive" e RFJ-së në akordimin e një lloji autonomie për Kosovën.

Një qasje e tillë nënkupton se Bashkimi Evropian nuk kishte ndryshuar qëndrimin karshi Kosovës dhe po vazhdonte me qëndrimin e vjetër për Kosovën në kuadër të Serbisë. Një tjetër argument që e vërtetonte këtë konstatim është se komuniteti ndërkombëtar tani filloi të angazhohej për zgjidhjen e çështjes së arsimit në Kosovë, me shpresën se një gjë e tillë do ta qetësonte situatën e do t'i hapte rrugë dialogut të mëtejshëm midis Serbisë dhe shqiptarëve në Kosovë. Me ndërmjetësimin e komunitetit katolik Shën Exhidio u arrit marrëveshja midis Ibrahim Rugovës e Slobodan Millosheviqit për kthimin e

nxënësve dhe studentëve në objektet e tyre duke filluar nga shtatori 1996.

Sigurisht, një marrëveshje e tillë nuk u zbatua, sepse ajo kishte qenë vetëm një lojë e Millosheviqit për ta hequr nga vetja presionin e komunitetit ndërkombëtar e njëkohësisht edhe për ta goditur rezistencën aktive shqiptare që kishte filluar t'i jepte shenjat e para në Kosovë. Në anën tjetër, një marrëveshje e tillë ishte e nevojshme edhe për Ibrahim Rugovën, pozitën politike të së cilit kishin filluar të veniten në Kosovë. Në këto rrethana, qëndrimi i tillë i komunitetit ndërkombëtar ndaj Kosovës, bëri që qarqe të ndryshme politike në Kosovë të mendonin për gjetjen e formave të tjera të rezistencës kombëtare. Deri tek një pikë e tillë çonin analizat që iu bënë vendimeve të Dejtonit. Pavarësisht kostos së izolimit ndërkombëtar, dënimeve për spastrimit etnik dhe gjenocid, serbët e Bosnjës kishin përfutur më shumë se sa kishin kërkuar.

Me fjalë tjera, marrëveshja e Dejtonit bëri të ditur se marrëveshjet territoriale në baza etnike në Ballkan, gëzonin legjitimitet në sytë e Perëndimit dhe se vetëm përdorimi i forcës në tentativat për arritjen e vetëvendosjes mund ta siguronte vëmendjen e Perëndimit. Në këtë kontekst, shumica e shqiptarëve në Kosovë tani u bindën se ishin shteruar mjetet politike dhe diplomatike për zgjidhjen e problemit, pasi komuniteti ndërkombëtar nuk e konsideronte Kosovën si problem serioz. Në anën tjetër, gjatë viteve 1995-1997 shtypja serbe vazhdonte ende më ritmin e vjetër, duke privuar shqiptarët nga të drejtat e tyre më elementare, në të gjitha segmentet e jetës ekonomike, shoqërore, arsimore, kulturore e politike. Lëvizja shqiptare e rezistencës pasive filloi t'i nënshtrohej një transformimi të pjesshëm pasi që një pjesë e

aktivistëve filloi t'i bashkëngjitej rrymave të reja. Në fakt, filloi një lëvizje aktive që fillimisht u shoqërua me demonstrata popullore. Një faktor tjetër që përshpejtoi organizimin e rezistencës aktive ishin ngjarjet e pranverës së vitit 1997 në Shqipëri. Skemat piramidale financiare që i kishte lejuar Qeveria shqiptare kishin arritur fundin e tyre të natyrshëm. Shqipëria ra në anarki. Qeveria shqiptare e kohës humbi kontrollin, kurse armatimet e braktisura nga forcat e sigurisë u vodhën. Qindra mijëra armë ishin në dispozicion të qytetarëve, sidomos pushkët automatike. Kjo ngjarje lehtësoi organizimin e rezistencës së armatosur. Një faktor tjetër që intensifikoi transformimin e rezistencës pasive në atë aktive ishte edhe Lëvizja Studentore, respektivisht demonstratat studentore të tetorit 1997. Dhuna e shfrenuar serbe kundrejt demonstruesve paqësorë bindi komunitetin ndërkombëtar për vështirësitë në demokratizimin e Serbisë, kurse ishte edhe një moment kthese, sepse ktheu vëmendjen e Perëndimit përsëri nga Kosova. Rritja e interesimit të diplomacisë së vendeve të Bashkimit Evropian dhe të SHBA-së, vërtetoi edhe njëherë se përfshirja ndërkombëtare ndodh vetëm pas eskalimit të situatës. Në aspektin e brendshëm, protesta po ashtu bindi popullatën shqiptare në Kosovë se me Serbinë është e pamundur marrëveshja në kushte paqësore, sidomos kur pas paqes në Bosnjë, Serbia i kishte duart e lira të merrej me Kosovën e në këtë mënyrë ta shtonte dhunën e represionin. Andaj, në kushtet e intensifikimit të dhunës dhe shtypjes së policisë serbe ndaj civilëve të pafajshëm, politikës së brendshme të vendit dhe indiferencës së faktorit ndërkombëtar, në Kosovë i erdhi fundi durimit dhe status quo-s. (Vijon)



Kryetari i Prishtinës dhe ambasadori i Malit të Zi diskutojnë për turizmin

PRISHTINË, 21 SHKURT (ER)- Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka pritur në takim ambasadorin e Malit të Zi në Kosovë, Mirsad Bibović. Rama ka thënë se për Kosovën dhe Malin e Zi ekzistojnë shumë mundësi bashkëpunimi ndërshtetëror

në sektorë të ndryshëm, veçmas në turizëm. "Diskutoam, mes të tjerash, edhe për mundësinë e hartimit të një plani bashkëpunimi mes dy kryeqendrave, Prishtinës dhe Podgoricës", ka thënë Rama pas takimit.



Komuna e Gjilanit pastron rrugët në qytet

GJILAN, 21 SHKURT (ER) - Komuna e Gjilanit gjatë fundjavës ka vazhduar pastrimin dhe larjen e rrugëve në qytet në kuadër të mirëmbajtjes për një ambient sa më të pastër. Drejtori i Shërbimeve Publike, Mentor

Mihovci, ka thënë se këto do të jenë angazhime të vazhdueshme. "Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës dhe Banimit, në bashkëpunim me operatorin për mirëmbajtjen e rrugëve, ka

vazhduar pastrimin dhe larjen e rrugëve edhe gjatë vikendit sipas kalendarit të punës, dhe do të vazhdojë edhe në ditët e ardhshme. Bashkë e pastrojmë Gjilanin", ka thënë drejtori Mihovci.



Të enjten deputetët e Kuvendit mbajnë seancë plenare

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 SHKURT - Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka mbajtur të hënën mbledhjen e radhës, së bashku me kryetarët e grupeve parlamentare, në të cilën është përcaktuar agjenda e punës së Kuvendit për këtë javë. Nën drejtimin e kryetarit Glauk Konjufca, Kryesia ka vendosur që, përveç seancës së sotme (e martë) të përcaktuar në mbledhjen e kaluar të kryesisë, Kuvendi do të mbledhet në seancë plenare edhe të enjten, më 24 shkurt, në të cilën pritet të shqyrtohen disa projektligje, të zhvillohet një debat, si dhe të shqyrtohen çështje të tjera të përcaktuara në rend të ditës.

Seanca do të fillojë me deklarime jashtë rendit të ditës dhe pyetje parlamentare, për të vijuar me shqyrtimin e Projektligjit nr. 08/L-126 për



ratifikimin e Marrëveshjes për sigurime shoqërore në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, si dhe

atë për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së

Shqipërisë për zbatimin e lehtësirave doganore dhe/ose të kontrollit të hyrjes/daljes së mallrave.

Më pas, Kuvendi do të debatojë

në lidhje me zhvillimet në dialogun Kosovë - Serbi, për të vijuar me shqyrtimin e dytë të Projektligjit nr. 08/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore. Për herë të parë, ndërkaq, pritet të shqyrtohet Projektligji nr. 08/L-005 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, Projektligji nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Projektligji nr. 08/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës si dhe Projekt-Kodi Civil i Republikës së Kosovës nr. 08/L-124.

Në rend dite të kësaj seance do të jetë edhe formimi i komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga radhët e komuniteteve të tjera joshumicë.



Nënshkruhen marrëveshjet për efikasitet të energjisë për katër shkolla të Mitrovicës

MITROVICË, 21 SHKURT (ER) - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka nënshkruar të hënën katër marrëveshje për shërbime të energjisë si vazhdimësi e zbatimit të masave të efikasitetit të energjisë në objektet publike të komunës së Mitrovicës. Me nënshkrimin e këtyre marrëveshjeve katër shkolla të komunës së Mitrovicës do të përfitojnë nga ky projekt i

fushës së efikasitetit të energjisë, ShFMU "Elena Gjika", çerdhja publike "Gëzimi Ynë", ShMLE "Hasan Prishtina" dhe ShFMU "Eqrem Qabej".

Projekti në fjalë pritet të fillojë të realizuar nga muaji qershor i këtij viti, ndërsa financimi i tyre bëhet nga Qeveria e Kosovës, Zyra e BE-së dhe Banka Botërore përmes Fondit të Kosovës për Efikasitet të Energjisë.

Bien rastet me Covid-19

PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se nga 1 595 testime, 101 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit është shënuar një rast i vdekjes. Të hënën janë

shënuar 758 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shënuarve është 218 265.

Në total numri i rasteve aktive me Covid është 3 883. Në 24 orët e fundit janë dhënë 195 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në

të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 807 516 doza të vaksinës. Deri më sot 813 185 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë, ndërsa janë dhënë 96 011 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



AMBULANCA PËR

Dyfishohen eksportet e Shqipërisë drejt Kosovës

PRISHTINË, 21 SHKURT - Marrëdhëniet tregtare mes Shqipërisë dhe Kosovës po vijnë duke u zgjeruar vit pas viti. Sipas raportit të publikuar nga Instituti i Statistikave (INSTAT) mbi tregtinë e jashtme, eksportet drejt Kosovës gjatë muajit janar të këtij viti arritën 2.7 miliardë lekë [22.3 milionë euro] duke u dyfishuar, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021. Ndërkohë, importet shënuan një rënie të lehtë duke arritur në 520 milionë lekë [4.3 milionë euro] nga 539 milionë lekë [4.5 milionë euro] që ishin në janar të 2021-shit.

Eksportet kryesore të Shqipërisë drejt Kosovës përfaqësohen nga eksporti i materialeve të ndërtimit dhe metaleve, mineraleve dhe lëndëve djegëse, ushqimeve si dhe produkteve kimike dhe plastike. Të rëndësishme në strukturën e eksporteve shfaqen prodhimet vendase të drurit/mobilierisë si ndenjëset (karrige e kolltukë) apo mobilie të tjera. Gjithashtu, edhe prodhimet bujqësore kanë peshë, ndër të cilat eksportin kryesor e zënë domatet, agrumet, pjeperi dhe kastravecët. Gjatë kësaj periudhe, referuar të dhënave, Shqipëria ka eksportuar më tepër drejt Kosovës minerale lëndë djegëse, energji elektrike pasuar nga grupi materiale ndërtimi dhe



metale. Vlera e eksporteve të këtyre dy grupeve llogaritet mbi 900 milionë lekë [7.44 milionë euro] respektivisht.

Po ashtu, Shqipëria ka eksportuar drejt Kosovës produkte kimike dhe plastike në vlerën e 337 milionë lekëve [2.78 milionë euro].

Por shkëmbimet ekonomike mes dy vendeve janë shumë më të gjera se vetëm flukset tregtare. Ato shtrihen në shkëmbime ekonomike në industrinë e turizmit, shërbimeve financiare, shkëmbime në fushën e arsimit dhe teknologjisë, transportit apo telekomunikacionit.

Potenciali është më i madh dhe i qëndrueshëm për specializim të bashkëpunimit ekonomik dhe rritje të konkurrueshmërisë, me anë të konsolidimit të zinxhirit të vlerës nëpërmjet shkëmbimeve ndërsektoriale, në fusha si agropërpunim, industri kimike dhe kozmetike, prodhim artikuj

paketimi prej plastike dhe letre dhe përpunim i metaleve. Nga sektorët e pashfrytëzuar deri tani, potencial për shkëmbime tregtare shfaqin sektorët si tekstilet, prodhimet e lëkurës, makineritë, prodhimet e detit dhe produktet e drurit të përpunuar.

Murati vlerëson bashkëpunimin dhe mbështetjen e Bankës Evropiane për Investime



PRISHTINË, 21 SHKURT (ER) - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka takuar të hënën delegacionin e Bankës Evropiane për Investime (BEI) të kryesuar nga zëvendës-presidentja Liliana Pavlova në premisat qendrore të BEI-së në Luksemburg.

Ministri Murati ka vlerësuar bashkëpunimin dhe mbështetjen që Banka Evropiane për Investime i ka dhënë Republikës së Kosovës. Gjatë periudhës së pandemisë, BEI e ka ndihmuar Kosovën me 70 milionë euro në funksion të rimëkëmbjes së qëndrueshme pas situatës pandemike.

Zëvendës-presidentja e BEI, Lilyana Pavlova, ka vlerësuar vizitën e delegacionit të Kosovës, duke theksuar rëndësinë e këtij

bashkëpunimi për përbushjen e nevojave të qytetarëve të Kosovës. Synimi i përbashkët i të dyja palëve është që të rritet mbështetja financiare dhe teknike duke vepruar në linjë me Agjendën e Gjelbër dhe Digjitalë të Bashkimit Evropian.

Ministri Murati gjatë këtij takimi ka bërë me dije se shteti i Kosovës është fokusuar në zvogëlimin e ndikimit të pandemisë si dhe në ringjalljen ekonomike. "Andaj mirëpresim planin ekonomik dhe investiv të BE-së i cili synon zhvillimin ekonomik të Ballkanit Perëndimor", ka thënë ai.

Si rezultat, të dyja palët u zotuan ta thellojnë bashkëpunimin në mënyrë që të konsolidojnë hapa të suksesshëm drejt agjendës së përbashkët të zhvillimit.

Konjufca i ofron mbështetje bordit të KPMM-së

PRISHTINË, 21 SHKURT (ER)- Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të hënën në takim anëtarët e Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), të prirë

nga kryesuesja Selvete Grajqevci - Pllana. Me këtë rast, anëtarët e Bordit të KPMM-së e kanë njoftuar kryetarin e Kuvendit për aktivitetet aktuale, për sfidat me të cilat po përballet sektori minier në Kosovë si

dhe planet për të ardhmen. Ndërsa kryetari Konjufca ka premtuar mbështetje për angazhimet e këtij bordi në funksion të mbrojtjes së resurseve minerare të vendit dhe parandalimit të degradimit mjedisor.



Si do të ishte një pushtim rus i Ukrainës? Ja cilët janë 3 skenarët më të mundshëm



Nga David J. GALBREATH
"The Conversation"

Pavarësisht se Kremli pretendon të kundërtën, Ukraina mbetet e rrethuar nga trupat ruse, si përgjatë kufirit të saj të gjatë me Rusinë, po ashtu edhe nga brenda Krimesë së pushtuar. Federata Ruse ka vendosur atje forca të shumta tokësore, ajrore dhe detare, që i japin Moskës një sërë mundësish nëse do të synojë të nisë veprimet ushtarake.

Nuk është hera e parë që trupat ruse duken të gatshme ta sfidojnë sovranitetin e Ukrainës. Dhe Perëndimi duket se nuk e di se çfarë të bëjë në këtë situatë, pa rrezikuar luftën midis shteteve të armatosura me armë bërthamore. Rusia e ka krijuar terrenin për operacionet ushtarake kundër Ukrainës që nga viti 2014, kur pushtoi Krimenë, duke fituar një bazë të madhe ushtarake në jug. Ndërkohë, lufta e vazhdueshme në rajonin ukrainas të Donbasit në lindje, i jep mundësi njëse ruse të sigurisë dhe inteligjencës të vazhdojnë të vlerësojnë operacionet ushtarake të palës kundërshtarë. Në pranverën e vitit të kaluar, Rusia i shtoi veprimet kundër Ukrainës.

Ajo ndërmoi sulme kibernetike dhe fushata keqinformuese, si dhe ndërpreu furnizimin me energji të vendit fqinj. Shërbimi

i Sigurisë në Ukrainë ka identifikuar brenda kufijve të saj disa njësi operative të Shërbimit Federal rus të Sigurisë, Shërbimit të Inteligjencës së Jashtme, Inteligjencës Ushtarake dhe Forcave Speciale ruse. Nëse ndodh një sulm ushtarak, ai do të zhvillohet në një nga këto 3 mënyra:

Skenari i parë: Rrëzimi i udhëheqjes aktuale në Ukrainë

Në këtë skenar, forcat ushtarake dhe të sigurisë ruse do të përpiqen të rrëzojnë qeverinë aktuale në Kiev, për ta zëvendësuar atë me njerëz që janë më pro-rusë. Kjo do të kërkonte edhe mbajtjen në detyrë të disa njerëzve që tashmë janë duke punuar në administratën publike ukrainase.

Dhe në fakt ka disa figura që kanë treguar simpati dhe kanë bashkëpunuar me Federatën Ruse. Ky skenar mund të përfshijë edhe njësitë e sigurisë dhe të inteligjencës në Ukrainë, si dhe njësi nga ato që janë angazhuar në stërvitjet ushtarake që po zhvillohen aktualisht në Bjellorusi.

Shqetësimi më i madh për Rusinë në këtë skenar, do të ishte se si do të reagonte ushtria dhe policia ukrainase. Por ndërkohë, mund të ketë edhe

një reagim publik të konsiderueshëm kundër një ndryshimi të qeverisë të imponuar nga Moska.

Skenari i dytë: Do ketë luftë vetëm në Ukrainën Lindore

Në këtë rast, trupat ruse do të synonin të përforconin mbrojtjen e rajoneve të shkëputura në Donbas me armë, furnizime dhe të dhëna nga shërbimet sekrete. Më pas këto zona do të përdoren si një trampolinë për të marrë më shumë territore ukrainase, kryesisht ato zona ku jetojnë rusët etnikë dhe ukrainasit rusisht-folës.

Një manovër e tillë mund t'i çojë trupat ruse deri në lumin Dnjepër, i cili ndan vendin në lindje dhe perëndim. Kjo vijë ndarëse mund të shtrihet përgjatë bregut të Detit të Zi deri në kufi me Moldavinë (ku ndodhet një rajon tjetër separatist nën kontrollin e Rusisë).

Një operacion i tillë do të mbështetej nga forcat ushtarake të stacionuara përreth rajonit rus të Rostov-mbi-Don, në lindje të Ukrainës, forcat në jug të stacionuara në Krime, por edhe batalionet e motorizuara të ushtrisë ruse të stacionuara në Transnistrian separatiste në Moldavi.

Skenari i tretë: Pushtim i plotë i Ukrainës

Në këtë skenar trupat ruse do të përdorin përvojën e fundit në operacionet luftarake në Siri, për të mposhtur çdo kryengritje popullore kundër forcave ruse. Kjo qasje do të kishte pasojat shkatërrimtare për popullin e Ukrainës. Do të kishte një numër të lartë viktimitash në radhët e forcave ushtarake dhe policore të Ukrainës, por edhe tek popullatat lokale që janë pranë fushëbetëve. Po ashtu, do të ketë flukse të mëdha refugjatësh drejt Perëndimit të Ukrainës dhe në shtetet kufitare të Polonisë, Hungarisë, Rumanisë dhe Moldavisë. Një krizë e tillë refugjatësh, mund të jetë më e madhja në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore.

Pasoja të frikshme

Është e rëndësishme të theksohet se këto skenarë nuk janë reciprokisht përjashtues të njëri-tjetrit. Madje, nëse Kremli nuk është i kënaqur me ndryshimet që sheh në Ukrainë apo në Perëndim, ato skenarë mund të ndodhin njëri pas tjetrit. Pavarësisht se çfarë bën Rusia, vendet e tjera që kanë mosmarrëveshje të pazgjidhura për territoret e shkëputura, si Moldavia me Transnistri dhe


Gjeorgjia me Osetinë e Jugut dhe Abkazinë, do t'i shikojnë me nervozizëm këto zhvillime. Një fitore e Rusisë në Ukrainë, mund të nxisë veprime kundër këtyre vendeve në të ardhmen.

Dhe nëse Perëndimi dështon që të reagojë me forcë, edhe vende si Estonia dhe Letonia mund të përballesh me kërcënime në të ardhmen. Kërcënimi ushtarak i Rusisë kundër Ukrainës, e ka vendosur Perëndimin në një pozitë të vështirë. Ai duhet të vendosë se si të përballet me një Rusi luftarake, dhe deri ku duhet të zgjerohet, në Ukrainë, Gjeorgji, apo më gjerë.

Dhe vendimmarrja e tij nuk ndihmohet aspak nga fakti që Shtetet e Bashkuara këto kohë janë shumë të shqetësuara për Kinën, Detin e Kinës Jugore dhe statusin e Tajvanit, sesa përfatin e Evropës Lindore. Për më tepër, nëse nuk ka një përgjigje të besueshme ndaj Ukrainës përmes diplomacisë, ndihmës ushtarake, ndoshta edhe reagimit ushtarak, në rrezik mund të jetë edhe ardhmja e NATO-s.

Një humbje e tillë e besueshmërisë, do të ishte një fitore e madhe për Rusinë, e cila e sheh aleancën si një kërcënim për sigurinë e saj kombëtare dhe për strategjinë e saj globale për të rifituar fuqinë që kishte dikur. Pra nuk mund të nënvlerësohet rëndësia e situatës në Ukrainë.

Bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Ahmeti dhe Ejupi konfirmojnë kandidaturat për kryetar të FFK-së

Pesë persona deri tash e kanë konfirmuar kandidimin për të parin e Federatës së Futbollit të Kosovës. Të fundit që e kanë bërë një gjë të tillë janë Remzi Ejupi dhe Arianit Ahmeti. Ky i fundit ka treguar se deri tash i ka mbledhur 15 nënshkrime dhe se në ditët e ardhshme do të paraqesë edhe planprogramin



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 SHKURT - Gara për kryetar të Federatës së Futbollit të Kosovës pritet të jetë shumë e "nxehtë". Kryetari aktual Agim Ademi do të sfidohet nga ish-zëvendëssekretar i FFK-së, Arianit Ahmeti dhe ish-presidenti i FC Prishtina, Remzi Ejupi. Ky i fundit të dielën në një emision sportiv ka deklaruar se është duke punuar rreth një plani i cili fillimisht do t'u paraqitet klubeve para kuvendit zgjedhor të FFK-së. "Jemi duke punuar një plan me ekip ndërkombëtar. Do të prezantohet para klubeve. Do të mundohemi të vendosim kriteret, standardet, se kush ka të drejtë", ka thënë Ejupi në "Dueli Sportiv".

Kandidimin për numrin një të Federatës së Futbollit të hënën e konfirmoi edhe Arianit Ahmeti përmes një njoftimi në profilin e vet në "Facebook". Ahmeti, që kohë më parë ishte përjashtuar nga FFK-ja, ka bërë me dije se deri tash i ka marrë

mbi 15 nënshkrime, kurse në ditët e ardhshme do ta bëjë publik edhe planprogramin. "Të nderuar futbolldashës, ju drejtues të klubeve, donatorë dhe komunitet i futbollit në vendin tonë, ju informoj se tanimë edhe zyrtarisht se do të jem kandidat për kryetar të Federatës së Futbollit të Kosovës. Unë kam pritur që FFK zyrtarisht t'i shpall zgjedhjet për kryetar për ta rishpallur kandidaturën time të cilën e kam shpallur në nëntor 2019, atëherë kur, sipas statutit të FFK-së, do të duhej të mbaheshin zgjedhjet për kryetar të FFK-së në janar 2020. Mirëpo duke parë që udhëheqja e aktuale e FFK-së nuk i mbajti zgjedhjet sipas Statutit në vitin 2020, dhe sot nuk është transparente dhe është involvuar në mbledhje të nënshkrimeve për kandidim për kryetar ende pa u shpallur zgjedhjet që tani duhet të mbahen në korrik 2022. Ju konfirmoj se kam mbështetjen e klubeve (mbi 15) të nevojshme për kandidim për

kryetar të FFK-së. Në ditët në vijim do ta prezantoj programin tim për udhëheqje të FFK-së. Me të gjithë futbollëdashësit do të bashkëpunoj për ta bërë ndryshimin e duhur për ta zhvilluar futbollin tonë, që vitet e fundit u degradoi shumë nga Agim Ademi i cili ia humbi shkëlqimin dhe imazhin pozitiv që e kishte futbollit ynë", ka thënë Ahmeti, i cili ka bërë thirrje që zgjedhjet të jenë të lira dhe jo garë për klane më të forta. "Për futbollin tonë është e domosdoshme që zgjedhjet në FFK të jenë të lira, transparente dhe demokratike, e jo zgjedhje të montuara apo të dirigjuara. Gara për kryetarin e FFK-së duhet të jetë për programet më të mira nga të cilat përfiton futbollit dhe jo për klane më të forta nga të cilat përfitojnë individët dhe humbet futbollit", ka shtuar ai.

Muaj më parë kandidimin për të parin e FFK-së e kanë bërë me dije edhe trajneri Bekim Shotani dhe ish-kryetari i skuadrës së Llapit, Nexhat Dumnica.

SHKURT

Magathi refuzon ofertën e Kosovës

Trajneri gjerman Felix Magath ka bërë me dije se e ka refuzuar ofertën e Federatës së Futbollit të Kosovës për pozitën e trajnerit në Përfaqësuesen e Kosovës. Në një intervistë për "kicker", 68-vjeçari thotë se mund ta kishte nisur një aventurë në Kosovë, por në fund e hodhi poshtë ofertën. "Kam folur me përfaqësuesit nga Kosova. Në punë ka njerëz të përkushtuar. Unë, gjithashtu, do të shkoja përsëri në Kinë. Unë i di kufijtë e mi si trajner, por e di që jam ende në gjendje t'i ndihmoj skuadrat", ka thënë Magath.

Muriqi: Nuk e merituan humbjen

Sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi, ka shkëlqyer në kampionatin spanjoll me skuadrën e Mallorcas. Ai ka realizuar gol edhe në ndeshjen ndaj Real Betis, e cila përfundoi me rezultat 2-1. Sulmuesi "dardan" ka thënë se skuadra e tij nuk e ka merituar humbjen. "Nuk e kemi merituar humbjen në këtë përballje. Kemi mundur të marrim një pikë ndaj një rivali të vështirë si Betisi. Penalltia ishte e turpshme dhe nuk mendoj se duhej të akordohej, por ne duhet të vazhdojmë të luftojmë. Jam i lumtur me golin, por dua që ai të shërbejë për të fituar pikë", ka thënë Muriqi.

Kosova e fiton medaljen e parë në Evropian në sportin e muaythait

Ekipi i muaythait të Kosovës ka përfunduar pjesëmarrjen në Kampionatin Evropian të Muaythait të mbajtur prej 12-20 shkurt 2022 në Stamboll të Turqisë. Nga gjashtë pjesëmarrës, u dallua Erona Shabani, e cila u ngjiti në podium si medaliste e bronzit, në kategorinë -54 kg të grupmoshës U-23, në të cilën ishin pesë garuese. Një fitore në Kampionat e shënoi Arbos Maliqi në kategorinë -67 kilogramë për seniorë, por që u ndal në çerekfinale. Për sportin e muaythait në Kosovë është medalja e parë nga një kampionat evropian.

Ish-sulmuesi i Anglisë: Broja ka të ardhme te Chelsea

Paul Merson, një tjetër emër i njohur në Angli, pasi ka luajtur me kombëtaren 21 ndeshje dhe ka qenë për 12 vjet pjesë e Arsenalit, ka lavdëruar sulmuesi e kombëtares shqiptare Armando Brojën. Merson, i cili tani është ekspert në "Sky Sports", mendon se djaloshi që po spikat me Southampton në sezonin e tij të parë në Premier Ligë ka të ardhme te Chelsea. "Armando Broja është një lojtar që me të vërtetë më ka rënë në sy këtë sezon dhe unë besoj se ai ka një të ardhme te Chelsea. Ai është i madh, është i fortë, është i shpejtë dhe ka treguar që mund të shënojë gola vazhdimisht në nivelin më të lartë", ka deklaruar Merson.

Hamiti, ylli i javës në Superligë

SKENDERAJ, 21 SHKURT - Federata e Futbollit të Kosovës së bashku me sponsorin e Superligës, Bankën Kombëtare Tregtare, BKT Kosova, vazhdojnë ta ndajnë çmimin "ylli i javës" për lojtarin më të mirë të xhiros. Këtë çmim për xhiros e 20 në

BKT Superligë e ka fituar futbollisti në radhët e KF Drenica, Genc Hamiti. Mesfushori ofensivë i kuqezinjve ishte lojtari më i mirë i ndeshjes në fitoren që skuadra e tij e realizoi si mysafire në stadiumin "18 Qershori" në

Klinë kundër KF Dukagjini me rezultat 1-2. Ai asistoi në të dyja golat për bashkëlojtarët e tij, derisa ishte mjaft kreativ gjatë tërë ndeshjes, duke qenë më i merituari që Drenica arketoi tri pikë të rëndësishme nga ky udhëtim. Pas kësaj fitoreje FC

Drenica stabilizohet në renditje, pasi aktualisht ndodhet në pozitën e 5-të në BKT Superligë me 27 pikë. Çmimin "ylli i javës" për mesfushorin e KF Drenica, Genc Hamiti, e ndau Fatmir Tupella, menaxher i degës së BKT-së në Drenas.



Përquku, MVP në elitën e femrave

PRISHTINË, 21 SHKURT - Në fundjavë u zhvillua xhironja e 15-të në Superligën e Femrave. Derbi u zhvillua në mes të Penzës dhe Prishtinës, ku fitoi skuadra prishtinase 82:87. Në këtë përballje shkëlqeu Arbnore Përquku me 23 pikë, nëntë kërcime

dhe dhjetë asistime, duke qenë basketbollistja më meritore që kryeqytetaset regjistruan fitoren e 15, duke mos pësuar asnjë humbje. Ajo u ndihmua nga Agnesa Rrahmani, e cila kontribuoi me 26 pikë e shtatë kërcime. Bashkimi shënoi fitore të

pritur ndaj Trepçës me shifrat 71:47, ku u dallua D'asia Chambers me 18 pikë, tetë kërcime dhe katër asistime. Fitore të prituri regjistroi edhe Vëllaznimi ndaj Kastriotit 117:53, ku skuadra ferizajase nuk di për fitore në këtë edicion në elitën e femrave.

Te skuadra kuqezi u dalluan dyshja Rina Hoda-Kendra Williams. Kapitenia Hoda kishte 25 pikë, tetë kërcime, 20 asistime dhe 12 topa të vjedhur, ndërkohë Williamsi shtoi 38 pikë, gjashtë kërcime, tre asistime dhe 12 topa të vjedhur.



ARBNORE PËRQUKU
23 PIKË / 10 ASISTIME / 9 KËRCIME

Ish-basketbollisti i NBA-s viziton Kosovën

PRISHTINË, 21 SHKURT - Ish-basketbollisti i njohur i NBA-s, Jiri Welsch, ndodhet për vizitë në Kosovë. Qëllimi kryesor i vajtjes së tij këtu është fillimi i Junior NBA Kosova. Welsch ka karrierë të pasur në ligën më të fortë në botë dhe në ligat evropiane. Welsch është 42-vjeçar dhe ka përfaqësuar Republikën e Çekisë. Ai karrierën e filloi në skuadrën Pardubice, për të vazhduar më pas në Sparta Praga dhe Union Olimpija. Nga viti 2002 deri më 2006 luajti në NBA për skuadrat Golden State Warriors, Boston Celtics, Cleveland Cavaliers dhe Milwaukee Bucks. Karrierën e vazhdoi në Evropë, te skuadrat Unicaja Malaga, Estudiantes Madrid, Spirou Charleoi, CEZ Nymburk dhe e përfundoi aty ku e filloi në Pardubice. Ai fitoi një herë Ligën Adriatike, u zgjodh tri herë basketbollisti më i mirë në Çeki, ka fituar tri herë Ligën e Çekisë, dy herë Kupën e Çekisë,



një herë kampion i Sllovenisë, dy herë Kupën e Sllovenisë dhe një herë u shpall MVP i Kupës në Slloveni. Jiri Welsch gjatë ditës së sotme do të ketë një drekë pune me sekretaren e përgjithshme të FBK-së, Elvira Dushku dhe përgjegjësin e Junior NBA për

Kosovë, Adrian Carrion, më pas takim me kryetarin e FBK-së, Arben Fetahu, ndërsa më pas do të ketë një stërvitje me djem dhe vajza (të lindur 2009-2010-2011). Të martën do të jetë pjesëmarrës në hedhjen e shortit për fillimin e Ligës Junior NBA Kosova.

NBA bën 75 vjet, spektakël në 'All Star Game', triumfon ekipi i LeBron James

CLEVELAND, 21 SHKURT - Spektakël në supersfidën e "All Star Game" në NBA. Skuadra e LeBron Jamesit fitoi 163-160 ndaj ekipit të Kevin Durantit, ndeshje e luajtur në Cleveland. Një përballje magjike mes yjeve të NBA-së, ku më i miri u shpall Stephen Curry, autor i 50 pikëve për skuadrën e LeBron Jamesit. Ai mori edhe trofeun "Kobe Bryant", çmim që i jepet lojtarit më të mirë të skuadrës fituese. Stephen Curry realizoi 16 gjuajtje të sakta për tri pikë, rekord për një ndeshje të "All Star Game". Ndërkohë që vetë LeBron Jamesi ishte protagonist i fitores, me koshin e realizuar në momentin e fundit të lojës. Një ndeshje magjike e yjeve organizuar në 75-vjetorin e NBA-



së, ndërkohë që të pranishëm në stadium ishin mjaft ikona të basketbollit amerikan. Për sa i përket sfidës, ajo ishte mjaft e bukur, spektakolare dhe me shumë emocione deri në

momentin e fundit. Përveç Curry, u dalluan edhe Antetokounmpo me 30 pikë e LeBron me 24 pikë. Në kahun tjetër, Embiid realizoi 36 pikë, por që nuk mjaftuan për ta evituar humbjen.

SHKURT

Xavi: Pedri është më i miri në botë

Trajneri i Barcelonës, Xavi Hernandez, e ka lavdëruar mesfushorin Pedri pas fitores kundër Valencias (1-4). Trajneri spanjoll ka thënë se Pedri është talenti më i madh në botë. "Nuk ka asnjë lojtar në botë me aq talent sa Pedri dhe ai është vetëm 19 vjeç. Ai është absolutisht madhështor. Mënyra si kthehet, kuptimi i hapësirës dhe kohës dhe fakti që përdor të dyja këmbët. Është e mahnitshme ta kemi atë në ekip dhe ne duhet të kujdesemi për të. Ai hyri në fushë për gjysmë ore dhe u bë menjëherë i rëndësishëm. Ai bën dallimin, në mënyrën se si ne luajmë, në kuadrat, ai i fiton topat mbrapa. Ne kërkuam që ai të godasë më shumë dhe tani ai ka tre gola, që kur u kthye nga lëndimi. Ai nuk është një lojtar normal. Ka shumë pak si ai. Ndoshta, në moshën e tij, ai tashmë është më i miri në botë në pozicionin e tij", ka thënë Xavi.

Mbappe ka disa kërkesa për të qëndruar në PSG

Sulmuesi Kylian Mbappe ende nuk është përcaktuar për të ardhmen e tij. Francezi kërkohet me ngulmë nga Real Madridi, por edhe PSG-ja është e gatshme të bëjë "luftë" për ta mbajtur yllin e saj. Sipas "LEquipe", Mbappe është i gatshëm për të qëndruar në Paris, por kërkesa e tij është që ai të jetë gjuajtës i penalltive dhe klani i Messid dhe Neymarit të mos këtë privilegje jashtë normës. Një tjetër kërkesë e Mbappës është që klubi ta prish kontratën me Sergio Ramos, i cili shumicën e kohës është i lënduar.

Icardi pëlqen Italinë para Anglisë

Mauro Icardi pritet të largohet nga PSG-ja në afatin kalimtar të verës. Sulmuesi argjentinas nuk po ka hapësira në klubin francez pasi treshja aktive është Messi-Mbappe-Neymar. 29-vjeçari nuk ka pasur një aventurë të mirë me klubin francez ku nuk ishte ai "bomberi" që pritej pasi erdhi nga Interi. Në 88 ndeshje me PSG, Icardi ka shënuar 38 gola dhe ka asistuar 10 herë. Në Itali, me ekipin zikaltër ai luajti 219 ndeshje dhe shënoi 124 gola dhe 29 asistime të kryera. Icardi thuhet se ka refuzuar në Angli ofertën e Arsenalit dhe të Newcastle, por ai pëlqen të rikthehet përsëri në Serinë A. Momentalisht klubet që e vrojtojnë janë Milani, Napoli dhe Roma. Vlera e kartonit është 30 milionë euro, por problem mbetet paga e tij e cila është 10 milionë euro në sezon. De Gea: Nuk e shoh veten larg Unitedit Portieri i Manchester Unitedit, David de Gea, thotë se nuk e sheh veten larg "Old Trafford". Spanjollin në vitet e kaluara ka qenë i lidhur me largimin nga "Dajti e Kuq", por gjithmonë refuzoi ofertat duke i qëndruar besnik klubit anglez. "Tani ndihem si të jem nga Manchesteri, sinqerisht nuk e shoh veten larg Unitedit. Ndihej si të gjithë të tjerët. Kur je i dashur dhe i mirëpritur është shtëpia jote. Kam qenë këtu që disa vjet", ka thënë De Gea për "UEFA"-n. Ndërkohë, De Gea me shumë gjasë do të jetë titullar në përballjen ndaj Atletico Madridit në Ligën e Kampionëve, sfidë që zhvillohet këtë të mërkurë.

Inzaghi: Një ekip që synon titullin s'mund të ketë këtë qasje

Skuadra e Interit pësoi humbjen e tretë sezonale në Serinë A, duke konfirmuar momentin e vështirë që po kalon. Pas duelit, trajneri Simone Inzaghi u shpreh i

zhgënjyer për mënyrën se si e administruan ndeshjen lojtarët e tij. "Jam shumë i zemëruar për trajtimin që i bëmë ndeshjes. Sassuolo kishte fituar me Milanin këtu

dhe në Torino me Juventusin. Duhet të ishim më të kujdesshëm. Në pjesën e dytë u përpoqëm të organizonim diçka, por nuk patëm asnjë episod. Ne duhet të kishim

një tjetër qasje ndaj ndeshjes. Tani do të analizojmë me qetësi, do të përpiqemi të gjejmë energji fizike dhe mendore. U përpoqëm ta rihapnim takimin, por nuk ia

dolëm dot. Kishim disa mungesa të rëndësishme, por ne duhet të jemi më të fortë se mungesat, episodet apo pezullimet", ka deklaruar Inzaghi.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Jeta-3M” ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 70297781. me pronar Mentor Rexhepaj, ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Jeta-3M” donelo odluku o prestani rada sa nrb. 70297781 Mentor Rexhepaj, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Jeta-3M” has come to the decision to quit its business: 70297781, Mentor Rexhepaj, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Under Control” Sh.P.K. me pronar Gëzim Rexhepi, me adresë “7 Shtatori”, Mitrovica e Veriut, ka marrë vendim të shuajë biznesin me NB: 810170168, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Under Control” D.O.O sa vlasnikom Gëzim Rexhepi, ulica “7 Shtatori” iz Severna Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom BB: 810170168 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that “Under Control”, L.T.D, Gëzim Rexhepi in Mitrovica e Veriut has taken the decision to quit its business with NB: 810170168, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 21.02.2022 bënë shpallje publike:

NJOFTIM PËR DHËNE KONTRATËS: T-22-01

Kemi pranuar dy ofertë.

Me kontratë shpërblehet

Loti 1 (Dhënia me Qira e Parcelës të tuneli) - Lulishtja Demi me çmimin 0.20 euro pa TVSH për metër katrore.

Loti 3 (Depoja e Koncentratit) - Camel SHPK me çmimin 0.60 euro pa TVSH për metër katrore

Kontratat janë paraparë të nënshkruhet me datën 25.02.2022 ora 10:00

NJOFTIM PËR ANULIM : T-22-01

Loti 2. (Dhënia me Qira e Depos IK) - Nuk ka ofertë.

AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

| | | |
|------------------------------------|---------------------|-------------------------------|
| Emri zyrtarë: Trepça sh.a. | | |
| Adresa postare: Parku industrial | | |
| Qyteti: Mitrovicë | Kodi postarë: 40000 | Shteti: Kosovë |
| Kontakti: Burim HAJDINI | | Telefoni: +383 (0) 28 538 050 |
| Email: sales@trepcacorporation.com | | Faksi: +383 (0) 28 539 202 |
| www.trepcacorporation.com | | |

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 14 te Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania “KRU-Hidromorava” Sh.A. Gjilan, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për , Impiantin për trajtimin e ujërave të zeza në Z.K. Uglar, Komuna e Gjilanit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 17.03.2022 në ora 10:00 në objektin e K.R.U. Hidromorava sh.a. në Gjilan rr. Vëllëzërit Gërvalla pa nr. do të organizohet debat publik nga Kompania “KRU-Hidromorava” Sh.A. Gjilan në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, për Impiantin për trajtimin e ujërave të zeza në Z.K. Uglar, Komuna e Gjilanit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Platforma ZOOM Linku: : Bashkangjitur e gjeni linkun e rri ne platformen ZOOM :

Join Zoom Meeting

<https://us05web.zoom.us/j/85725799578?pwd=Y0FOaysveHBGQ1QwZHZjMlI4cUNNZz09>

Meeting ID: 857 2579 9578

Passcode: KR7wMy

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë “ KRU-Hidromorava” Sh.A. Gjilan, për Impianti për trajtimin e ujrave të zeza në Z.K. Uglar, Komuna e Gjilanit

https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

NJOFTIM

Në bazë të Ligjit për shoqëritë tregtare Nr.06/L-016, nenit 112 dhe nenit 114 njoftojmë të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe palët tjera juridike dhe fizike se akcionari i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, Proton Sh.p.k. me numër unik identifikues: 810792160 me seli në Prishtinë, Adresa: G.Majer Nr.7 Lok.Nr.1 ka marrë vendim për shuarjen vullnetare të subjektit afarist dhe ka caktuar likuidatorin e paanshëm Bashkim Aliu me ID: 1005481135 me vendbanim në Rr.Ali Kelmendi Nr.9, Komuna:

Prishtinë me tel: 045/242-455 për zhvillimin e procedurës së Likuidimit.

Njoftohen të gjithë furnitorët dhe klientët si dhe personat tjerë juridik dhe fizik që kanë interesa të porealizuara dhe raporte kreditore-debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

PROTESTË!

*Proteston, refuzon, mallkon, pena e shkrimtarit:
Kur burgosen çlirimtarët, burgoset edhe populli!*

Kur burgoset UÇK-ja, burgoset edhe liria!



"Hero në luftë, Hero në paqe" – 1



"Drenica para gjyqit" – 2



"UÇK-ja para gjyqit" – 3



"Na e ban hallall, Kosove" – 4



"Edhe malet janë UÇK" – 5



"Murtaja e Kuqe" – 6

(Këta janë 7 libra publicistikë, të botuar nga Riza Greiçevci për Gjykatën Speciale të Hagës, ku po gjykohen: UÇK-ja, çlirimtarët, Drenica, liria, dëshmorët, pushka e Adem Jasharit, Kosova...!)



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Berat Plava nga Gjakova, shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X, XI, XII të Gjimnazit "Hajdar Dushi".
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

